

THE JUDICIAL TRANSLATOR-INTERPRETER  
OF ENGLISH LANGUAGE  
PËRKTHYES-INTERPRET GJYQËSOR  
I GJUHËS ANGLEZE

**Rabit Krasniqi**

No. 2/46 date 28/02/20 13  
Tel. +377(0)44/177-798 Prishtinë



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA EZHVILLIMIT EKONOMIK / MINISTARSTVO EKONOMSKOG RAZVOJA / MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT

## **Privatizimi i Distribucionit dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike të Kosovës**

### **MARRËVESHJE IMPLEMENTIMI**

**Tetor 2012**

- (1) QEVERIA E REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS (QeK)**
  - (2) KORPORATA ENERGJETIKE E  
KOSOVËS SH.A. (KEK)**
  - (3) Çalik Enerji Sanayi Ticaret A.S.  
Anonim Sirketi & Çalik Elektrik  
Dagitim A.S. Anonim Sirketi dhe  
Limak Yatirim Enerji Uretim Isletme  
Hizmetleri ve Insaat A.S. Anonim  
Sirketi Consortium (Investitorët)**
  - (4) Kosovo Çalik Limak Energy Sh.A.  
(Blerësi)**
  - (5) KOMPANIA KOSOVARE PER  
DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME  
ENERGJI ELEKTRIKE SH.A.  
(KEDS)**
- 

**MARRËVESHJE IMPLEMENTIMI  
Në lidhje me  
KEDS DISTRIBUIMI DHE FURNIZIMI**

---

## Përmbajtja

1.	Përkufizimet, interpretimi dhe gjuha.....	2
2.	Efektshmëria dhe kohëzgjatja.....	2
3.	Obligimet e QeK.....	2
4.	Ndryshimi i Kontrollit të Investitorëve dhe të Drejtat dhe Obligimet e KEDS.....	4
5.	Fuqia madhore .....	9
	Rastet e fuqisë madhore.....	9
6.	Zhdëmtimi .....	11
	E drejta për mbrojtjen e veprimit.....	11
	Pala e zhdëmtuar të mos bëjë kompromis .....	12
7.	E pashfrytëzuar .....	12
8.	Shkëputja .....	12
	Mospërbushja nga ana e KEDS.....	13
	Shkëputja .....	13
9.	Zgjidhja e kontesteve.....	14
10.	Ligji i zbatueshëm .....	16
11.	Valuta, Data e Pagesës dhe Pagesat e Vonuara .....	16
12.	Ekzekutimi.....	16
13.	Imuniteti sovran.....	16
14.	Njoftimet .....	17
15.	Konfidencialiteti dhe Publiciteti.....	18
16.	Ndryshimet .....	18
17.	Mohimet .....	18
18.	Pasardhësit.....	18
19.	Delegimi dhe transferi i interesit .....	18
20.	Ndashmëria.....	19
21.	Marrëdhënia mes Palëve .....	19
22.	Mirëbesimi.....	19
23.	Sigurimi i mëtutjeshëm .....	20
24.	Tërësia e marrëveshjes .....	20
25.	Kostot .....	20
26.	Tejkalimi i afateve .....	20
27.	Kopjet .....	20
28.	Variacionet .....	20
	Shtojca 1 Përkufizimet dhe interpretimet.....	23
	Shtojca 2 Pjesa 1 Marrëveshja për Shitblerje të Aksioneve (MSHA), Pjesa 2 Marrëveshja për Furnizim me Shumicë (MFSH) dhe Pjesa 3 Marrëveshja për Furnizim nga Importi (MFI).....	27

**KJO MARRËVESHJE** nënshkruhet më **17 tetor** 2012, nga dhe mes:

- (1) **QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS (“QeK”)**, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, zyra kryesore e të cilës është Ministria e Zhvillimit Ekonomik; ish-Toskana Rr, Nëna Terezë, Prishtina 10000, Kosovë;
- (2) **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**, shoqëri aksionare e korporatizuar në Kosovë, me numër regjistrimi 70325399, me zyrën e saj të regjistruar në rrugën Nënë Tereza, nr. 36, Prishtinë, Kosovë (“**KEK**”);
- (3) **Calik Enerji Sanayi Ticaret A.S. Anonim Sirketi & Calik Elektrik Dagitim A.S. Anonim Sirketi dhe Limak Yatirim Enerji Uretim Isletme Hizmetleri ve Insaat A.S. Anonim Sirketi Consortium (“Investitorët”)**;
- (4) **Kosovo Çalik Limak Energy Sh.A. (“Blerësi”)**; dhe
- (5) **KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A.** kompani e themeluar në Kosovë, me numër regjistrimi **70606119**, me zyrën e vet të regjistruar në Zyrën nr.3 Bulevardi Bill Clinton, Prishtinë, Republika e Kosovës (“**KEDS**”).

Ku secila është “Palë”, së bashku “Palët”.

#### **SIPAS TË CILËS**

- (A) KEK është shoqëri aksionare e themeluar në pajtim me Ligjet e Kosovës, ku të gjitha aksionet e saj janë në pronësi të QeK-së;
- (B) KEK ka themeluar KEDS-në si shoqëri aksionare në pajtim me ligjet e Kosovës, ku të gjitha aksionet e saj janë në pronësi të plotë të QeK-së.
- (C) KEK do t’i bartë KEDS-it degët e KEK-ut për distribuim dhe furnizim të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës;
- (D) QeK, përmes Komisionit të Privatizimit, ka organizuar një proces të tenderimit konkurrent për përzgjedhjen e investitorëve nga sektori privat për të blerë aksionet në pronësi të saj, si dhe për të marrë pjesë në përgjithësi, në KEDS;
- (E) Investitorët kanë dorëzuar një ofertë për të përvetësuar gjithë kapitalin e aksioneve të ofruar në KEDS, përmes Blerësit, ndërsa kjo ofertë është pranuar nga QeK, në bazë të kushteve të Marrëveshjes për Shitblerje të Aksioneve, të të njëjtës datë me këtë Marrëveshje, kopja e së cilës është dhënë në Skemën 2, Pjesa 1 e kësaj Marrëveshjeje;
- (F) Për më tepër, KEK ka hyrë në një Marrëveshje për Furnizim me Shumicë dhe një Marrëveshje për Furnizim të Importit me KEDS-në, në të njëjtën datë me këtë Marrëveshje, kopjet e të cilave jepen në Skemën 2, Pjesa 2, respektivisht Pjesa 3 e kësaj Marrëveshjeje; si dhe
- (G) Duke marrë parasysh këto rregullime, si dhe në përpjekje për të shtyrë përpara synimet e veta, garancitë jepen dhe/ose bazohen mbi to sipas kësaj Marrëveshjeje, në bazë të dhe në pajtim me kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje.

**KËSHTU, PALËT JANË PAJTUAR** si në vijim:

## **1. Përkufizimet, interpretimi dhe gjuha**

- 1.1 Termet e përkufizuara në këtë Marrëveshje kanë kuptimin që iu është dhënë në Shtojcën 1, Pjesa 1.
- 1.2 Rregullat e caktuara të interpretimit që vlejnjë për këtë Marrëveshje janë përcaktuar në Shtojcën 1, Pjesa 2.
- 1.3 Gjuha e negocimit të kësaj Marrëveshjeje ka qenë anglishtja, kjo marrëveshje ekzekutohet në gjuhën angleze, ndërsa teksti në gjuhën angleze do të mbizotërojë për gjitha qëllimet e përcaktimit të qëllimeve të Palëve dhe në cilindo konstruktiv të kësaj Marrëveshjeje.

## **2. Efektshmëria dhe kohëzgjatja**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe efekt të plotë në datën e nënshkrimit të saj, si dhe prej kësaj date vazhdon të jetë në fuqi dhe efekt të plotë deri në ndërprerjen e saj në pajtim me nenin 8.

## **3. Obligimet e QeK**

- 3.1 QeK do të ofrojë si në vijim në mbështetje të KEDS-it, si dhe do të vazhdojë të bëjë këtë në lidhje me çdo riorganizim të aktivitetit të KEDS-it që shkon në drejtim të ndarjes së funksioneve të KEDS-it në lidhje me sistemin e distribuimit të energjisë elektrike nga furnizimi i energjisë elektrike, duke përfshirë edhe mënyrën e ndarjes së subjekteve juridike. Deri sa këto subjekte mbeten degë të lidhura të KEDS-it, obligimet e QeK-së sipas këtij neni 3 dhe kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të vlejnjë në dobi dhe në përkatësi me ato Degë, në të cilin kuptim KEDS do të ketë të drejtë të zbatojë ato obligime në emrin e tyre:

### **3.1.1 Licencat dhe Lejet e Punës**

- (a) Sipas ligjeve në fuqi, si dhe KEDS-it dhe kontraktorëve të tij që respektojnë kushtet për dhënien e një licence, lejeje apo pëlqimi, QeK pajtohet të ofrojë gjithë ndihmën e arsyeshme për KEDS-në në sigurim të atyre licencave, lejeve apo pëlqimeve të të gjitha llojeve e natyrave, si dhe përkatësisht kontraktorëve të tij, nga cilido Autoritet Kompetent në lidhje me Aktivitetin e KEDS-it, me kusht që çdo tarifë apo shpenzim i përcaktuar për atë licencë, leje apo pëlqim të paguhet nga KEDS-i sipas kushteve të caktuara; si dhe
- (b) Sipas ligjeve në fuqi, QeK pajtohet të ofrojë gjithë ndihmën e arsyeshme për Investitorët, Blerës dhe KEDS në dhënien e Lejeve të Punës dhe Vizave për Personelin e Huaj të KEDS-it që angazhohet në Aktivitetin e KEDS-it.

### **3.1.2 Mosdiskriminimi**

As QeK e as Autoritetet Kompetente nuk do të ndërmarrin veprime apo ndonjë kombinim veprimesh, përveç nëse lejohet me këtë Marrëveshje, i cili apo të cilët, në krahasim me subjektet e tjera të angazhuara, apo që mund të angazhohen në distribuim dhe furnizim të energjisë elektrike në Kosovë, apo në shitjen e energjisë elektrike për shpërndarje dhe furnizim, është apo janë diskriminues ndaj KEDS-it.

### **3.1.3 Performanca e KEK-ut**

Sipas ligjeve në fuqi, për aq sa mban pronësi mbi aksionet e KEK-ut, QeK do të sigurojë performancën e duhur të KEK-ut dhe kryerjen e obligimeve të

kontraktuara të KEK-ut të cilat rrjedhin drejtpërdrejt mes KEK-ut dhe KEDS—së, duke përfshirë por pa u kufizuar tek ato në MFSH dhe MFI.

#### 3.1.4 Llogaritë në valutë të huaj dhe riatdhesimi

- (a) As QeK e as Autoritetet Kompetente nuk do të vendosin ndonjë kufizim për KEDS-në në hapjen, mbajtjen apo veprimet me llogari në valutë të huaj, brenda apo jashtë Kosovës, të domosdoshme për Aktivitetin e KEDS-it.
- (b) QeK do të sigurojë që KEDS-i të jetë në gjendje, pa kurrfarë kufizimi, të blejë valutën e huaj, përmes subjekteve tregtare të lejuara sipas ligjeve të Kosovës për të ofruar valutë të huaj, për:
  - (i) Përbushjen e obligimeve të KEDS-it, nëse ka të tillë, të pagesës së shumave që kanë të bëjnë me huatë që merren për të financuar riparimet apo përmirësimet e Aktivitetit të KEDS-it (duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, pagesat e principalit dhe interesave dhe shpenzimeve tjera të financimit);
  - (ii) Rikthimin (riatdhesimin) nga KEDS-i të interesave, pagesave të huave, dividendëve apo shumave të tjera që i shpërndahen KEDS-it; si dhe
  - (iii) Rikthimin e pagave të personelit të huaj që punësohet nga KEDS-i.
- (c) QeK do të sigurojë disponueshmërinë e valutës së huaj për konvertim deri në masën e nevojshme për qëllimet e përshkruara në paragrafin (b).
- (d) Për të përbushur obligimet e veta sipas paragrafëve (b) (i) deri në (b) (iii) (përfshirëse), KEDS do të lejohet të rikthejë (riatdhesojë) shumat e nevojshme nga Kosova në valutë të huaj.
- (e) As QeK e as Autoritetet Kompetente nuk do t'i ndalojnë KEDS-it të pranojnë, nga jashtë Kosovës, fondet e nevojshme për Aktivitetin e KEDS-it.

#### 3.1.5 Mirëmbajtja e aksioneve

Në bazë të nenit 8.4 si dhe ligjeve të aplikueshme, as QeK e as Autoritetet Kompetente nuk do të ndërmarrin veprime që ta bëjnë të paligjshme për KEDS-në që të mbajë apo të vazhdojë të mbajë aksione në cilëndo Degë të Ndërlidhur që merret me cilëndo pjesë të Aktivitetit të KEDS-it, duke përfshirë bizneset e riorganizuar, të cilat ndajnë funksionet e pronësisë dhe operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike nga funksionet e blerjes dhe furnizimit të energjisë elektrike.

#### 3.1.6 Garancitë në lidhje me KEK-un, KOSTT-in dhe disa MBE

- (a) Sipas kërkesave të licencës nga ZRRE-ja, QeK do të punojë me KEK-un dhe ZRRE-në për të siguruar që KEK-u të mbetet i licencuar për të importuar energji elektrike në Republikën e Kosovës, për aq sa të ketë subvencion të QeK-së për KEK-un në prokurim të atyre importeve.
- (b) QeK do të sigurojë që rregullimet e përcaktuara me MBSH, MFI, si dhe rregullimet tjera të jenë të lejuara nga KOSTT-i, si dhe të mos dalin pengesa

ndaj atyre rregullimeve, për aq sa mund të dalin në lidhje me kyçjen dhe shfrytëzimin e sistemit të KOSTT-it si dhe rregullimet për balancim të sistemit.

- (c) Në lidhje me gjitha kodet teknike që kanë të bëjnë me rrjetin, kyçjen, njëhsimin, modifikimin e pajisjeve dhe në lidhje me rregullat e tregut, ashtu siç aplikohen nga KOSTT-i si operator i sistemit të transmisionit dhe tregut në Kosovë, QeK do të sigurojë që KOSTT-i t'i ofrojë KEDS-it gjithë mbështetjen dhe ndihmën që mund të kërkohet në masë të arsyeshme nga KEDS-i në implementim të atyre rregullimeve.
- (d) Në pajtim me kushtet e nenit 4.3, QeK do të punojë me palët përkatëse në gjitha negociatat dhe finalizimin e marrëveshjeve që janë subjekt i atij Neni.

#### **4. Ndryshimi i kontrollit të investitorëve dhe të Drejtat dhe Obligimet e KEDS-it**

##### **4.1 Ndryshimi i kontrollit**

Gjithmonë në pajtim me kërkesat e ligjshme të ZRRE-së, dispozitat në vijim vlejné për kontrollin mbi shumicën e aksioneve votuese në KEDS, në Degët e Ndërlidhura, si dhe krijimin e ndonjë pronësie apo zotimi mbi aksionet në KEDS:

- 4.1.1 Gjithmonë në pajtim me kërkesat e ligjshme të ZRRE-së, Investitorët nuk mund të shpërndajnë apo përndryshe të bartin aksionet e tyre tek Blerësi dhe/ose Blerësi nuk mund të shpërndajë apo përndryshe të bartë aksionet e veta në KEDS në çfarëdo transaksioni apo numri transaksionesh, me të cilat Investitorët pushojné të jenë në gjendje të kontrollojnë shumicën e aksioneve votuese tek Blerësi dhe/ose Blerësi pushon të jetë në gjendje të kontrollojë shumicën e aksioneve votuese në KEDS, pa palëqimin paraprak me shkrim të QeK-së. Një pajtim i tillë mund të tërhiqet nga QeK-ja në liri të plotë të veprimit, përveç nëse subjekti apo subjektet pranuese të kontrollit mund të demonstrojnë, deri në pëlqim të arsyeshëm të QeK-së, që ka apo kanë në dispozicion kompetencën teknike dhe/ose financiare për të siguruar që Aktiviteti i KEDS-it apo pjesët e tij mund të ushtrohen në mënyrën e duhur. Ky kufizim në shpërndarjen apo bartjen e aksioneve do të jetë në fuqi deri në përvjetorin e shtatë (7) të Përfundimit (sipas definicionit të tij) në Marrëveshjen për Shitblerjen e Aksioneve. Përveç këtyre, do të jetë kusht për secilën shpërndarje apo bartje të aksioneve, si dhe pa marrë parasysh a rezulton me pushimin e ushtrimit të kontrollit mbi shumicën e aksioneve votuese, që subjekti që përvetëson aksionet të hyjë në një marrëveshje obligative ligjore me QeK-në, me të cilën subjekti përvetësues merr përsipër para QeK-së të njëjtat kushte si Investitori dhe/ose Blerësi, sipas përcaktimit të tyre në nenin 4.1 dhe nenin 8.4, si dhe që asnjë bartje dhe/ose shpërndarje nuk mund të ketë efekt pa siguruar së pari hyrjen në fuqi me pëlqimin e QeK-së; si dhe/ose
- 4.1.2 Në lidhje me Degët e Ndërlidhura të angazhuara në cilëndo pjesë të Aktivitetit të KEDS-it, Investitori dhe/ose Blerësi dhe KEDS-i nuk mund të shpërndajnë apo përndryshe bartin aksionet e tyre tek ajo Degë, me një apo më shumë transaksione, me të cilat Investitorët dhe/ose KEDS-i, sipas rastit, pushojné të jenë në gjendje të ushtrojnë kontrollin mbi shumicën e aksioneve votuese në atë Degë pa pëlqimin paraprak me shkrim të QeK-së. Një pajtim i tillë mund të tërhiqet nga QeK-ja në liri të plotë të veprimit, përveç nëse subjekti apo subjektet pranuese të kontrollit mund të demonstrojnë, deri në pëlqim të arsyeshëm të QeK-së, që ka apo kanë në

dispozicion kompetencën teknike dhe/ose financiare për të siguruar që Aktiviteti i KEDS-it në të cilin është e angazhuar Dega e tillë të mund të ushtrohet në mënyrën e duhur. Ky kufizim në shpërndarjen apo bartjen e aksioneve do të jetë në fuqi deri në përvjetorin e shtatë (7) të Përfundimit (sipas definicionit të tij) në Marrëveshjen për Shitblerjen e Aksioneve. Përveç këtyre, do të jetë kusht për secilën shpërndarje apo bartje të aksioneve, si dhe pa marrë parasysh a rezulton me pushimin e ushtrimit të kontrollit mbi shumicën e aksioneve votuese, që subjekti që përvetëson aksionet të hyjë në një marrëveshje obligative ligjore me QeK-në, me të cilën subjekti përvetësues merr përsipër para QeK-së të njëjtat kushte si Investitori dhe/ose Blerësi, sipas përcaktimit të tyre në nenin 4.1 dhe nenin 8.4, si dhe që asnjë bartje dhe/ose shpërndarje nuk mund të ketë efekt pa siguruar së pari hyrjen në fuqi me pëlqimin e QeK-së; si dhe/ose

- 4.1.3 Dispozitat e neneve 4.1.1 dhe 4.1.2 vlejné në lidhje me secilin subjekt që mund të marrë aksione, duke përfshirë por pa u kufizuar në to, institucionet financiare dhe secilin subjekt që është subjekt i këtij neni 4.1.3, pa marrë parasysh a përfshihet apo jo në Shtojcën 3. Me kusht, megjithatë, që në rastin e një subjekti që miratohet nga QeK sipas këtij neni 4.1.3 ose përcaktohet sipas Shtojcës 3, dispozitat e neneve 4.1.1 dhe 4.1.2 do të kualifikohen deri në masën në të cilën secila letër me vlerë, bartje, kufizim apo zotim kërkon bartjen e aksioneve tek ai subjekt, në rastin e mospagesës sipas atij udhëzimi nga KEDS. Pa marrë parasysh si më lart, aty ku ai subjekt ka marrë përsipër bartjen e aksioneve si pasojë e mospagesës sipas një letre me vlerë, bartjeje, kufizimi apo zotimi, atëherë ai subjekt do të mbajë ato aksione në përputhje të plotë me nenet 4.1.1 dhe 4.1.2. Investitorët dhe/ose Blerësi nuk mund t'i ofrojë, krijojë apo lejojë asnjë letër me vlerë, shpenzim, kufizim apo zotim (pa marrë parasysh a ka të bëjë me pronësinë, kontrollin, përvetësimin apo dhënien, apo ndonjë çështje tjetër), mbi aksionet e KEDS-it apo ndonjë Dege të ndërlidhur të angazhuar në cilëndo pjesë të Aktivitetit të KEDS-it, ose që mund të ndikojë Aktivitetin e KEDS-it pa pajtimin paraprak të QeK-së, përveç nëse institucioni që merr përsipër letrat me vlerë, shpenzimet, kufizimet apo zotimet është i listuar në Shtojcën 3. Gjithmonë në pajtim me dispozitat e Nenit 8.4, marrëveshja e tillë nuk mund të ndalohet pa arsye. Ky kufizim për çdo letër me vlerë, shpenzim, kufizim apo zotim për aksionet do të jetë në fuqi deri në përvjetorin e shtatë (7) të Përfundimit (sipas përkufizimit të tij) sipas Marrëveshjes për Shitblerjen e Aksioneve.

## 4.2 Riorganizimi i KEDS-it

Në çfarëdo riorganizimi të KEDS-it, ashtu që të synohet që Aktiviteti i KEDS-it do të ndërmerret nga një subjekt juridik jashtë KEDS-it, atëherë do të ndërmerret nga një Degë. Në çdo rast, si dhe jo më vonë sesa përvjetori i parë i Datës së Përfundimit sipas Marrëveshjes për Shitblerje të Aksioneve, KEDS-i (si dhe Investitorët dhe/ose Blerësi do të sigurojnë që KEDS-i) do të ndajë pronësinë dhe operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike ashtu që aktiviteti i licencuar si operator i sistemit të distribuimit bëhet nga një Degë e pavarur nga gjitha aktivitetet tjera që nuk kanë të bëjnë me distribucionin, si dhe kjo do të bëhet në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës.

## 4.3 MBE-të e ardhshme

Investitori, Blerësi dhe/ose KEDS-i janë në dijeni për MBE-në për TCKR dhe MBE-në për Kosovën B (të riparuar), dhe nuk paragjykojnë të drejtën e tyre për të negociuar këto dokumente në tërësi. Sa u përket këtyre marrëveshjeve për blerje të energjisë dhe marrëveshjeve të ngjashme që në të ardhmen mund të arrihen në lidhje me projektet për energji alternative, Investitorët dhe Blerësi do të sigurohen që KEDS-i të zhvillojë negociata në mirëbesim



(përfshirë edhe ato lidhur me përjashtimet e bëra në bazë të nenin 4.2 dhe Shtojcës 2 të Rregullave të Ofertimit) dhe do të lidhin marrëveshje në bazë të negociatave të zhvilluara, me kusht që:

- 4.3.1 të zhvillohet një proces konkurrues dhe transparent i tenderimit në lidhje me MBE-të për TCKR dhe Kosovën B (të riparuar) dhe për të gjitha projektet tjera të energjisë alternative;
- 4.3.2 Investitorët, Blerësi dhe/ose KEDS-i të konsultohen lidhur me kushtet e MBE-ve të TCKR-së dhe Kosovës B (të riparuar) apo marrëveshjet për blerjen e energjisë alternative, nëse shfaqet nevoja, në të cilin drejtim Investitorët, Blerësi dhe/ose KEDS-i do të angazhohen përkrah këshilltarëve relevantë të transaksionit të Qeverisë së Kosovës dhe do të veprojnë me qëllim të mirë në kuptim të sajimit të marrëveshjeve gjegjëse për blerje të energjisë; dhe
- 4.3.3 Kushtet e MBE-së së TCKR-së dhe Kosovës B (të riparuar) apo marrëveshjet për blerje të energjisë alternative të jenë të arsyeshme në aspektin komercial sa i përket:
  - (a) Aftësisë së KEDS-it për të përmbushur obligimet e veta si furnizues publik i energjisë elektrike; (b)
  - (b) Aftësisë së gjeneratorit për të financuar kapacitete të reja gjeneruese dhe/ose për të vazhduar me operimin dhe/ose riparuar kapacitetet ekzistuese gjeneruese;
  - (c) Çmimit për MWh që ka rezultuar nga procesi konkurrues i tenderimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe/ose vazhdimin e operimit dhe/ose riparimin e kapaciteteve ekzistuese gjeneruese;
  - (d) Afatit deri në 20 vite;
  - (e) Sigurimit se kapaciteti nominal neto të mos tejkalojë 1,3000 MW; dhe
  - (f) Miratimit nga ZRRE të përfshirjes së ndikimeve të MBE-ve të TCKR-së dhe Kosovës B (të riparuar) apo marrëveshjeve për blerje të energjisë alternative në tarifat relevante të Afarizmit të KEDS-it dhe nën licencat e zbatueshme dhe/ose kushtet dhe konditat tjera të shërbimit; dhe nëse jo, këto marrëveshje po ashtu të përfshijnë mekanizma komercialisht të pranueshëm që adresojnë të gjitha pasojat negative financiare tek KEDS-i nga mosmiratimi nga ZRRE i përfshirjes së ndikimeve të MBE-ve të TCKR-së dhe Kosovës B (të riparuar) apo marrëveshjeve për blerje të energjisë alternative në tarifat relevante të Afarizmit të KEDS-it dhe nën licencat e zbatueshme dhe/ose kushtet dhe konditat tjera të shërbimit.

#### 4.4 Financat

KEDS-i do të ketë përgjegjësi të plotë dhe të vetme, me shpenzimet dhe rreziqet e veta, si dhe me rregullimet e financimit të domosdoshëm për Aktivitetin e KEDS-it si dhe përmbushjen e obligimeve sipas Marrëveshjeve të Projektit.

#### 4.5 Ofrimi i gjitha informatave sipas miratimeve

Pa paragjykuar sipërmarrjet e QeK-së në nenin 3.1.2(b), KEDS do të sigurojë gjitha informatat dhe dokumentacionin përkatës që kërkohet nga secili Autoritet Kompetent në lidhje me secilin aplikim për dhënie e çfarëdo licence, lejeje apo pëlqimi në lidhje me Aktivitetin e KEDS-it.

#### 4.6 Respektimi i Licencave

KEDS-i përgjatë gjithë kohës do të respektojë kushtet dhe afatet e Licencave për Distribuim, respektivisht për Furnizim, si dhe të çdo licence, lejeje apo pëlqimi që vlen për to, si dhe do të jetë përgjegjës për respektimin nga zyrtarët, punëtorët, drejtorët, agjentët, kontraktorët, si dhe Degët e të gjitha atyre licencave, lejeve apo pëlqimeve që vlejnë për to, në lidhje me kryerjen e detyrave në lidhje me Stabilimentet dhe Aktivitetin e KEDS-it.

#### 4.7 Detyra e ruajtjes së sigurisë së Stabilimenteve

KEDS-i në çdo kohë do të gëzojë të drejtat që gëzohen nga kompanitë e regjistruara kosovare në lidhje me mbrojtjen e pronës me ligj, si dhe në çdo kohë do të ndërmarrë gjitha masat e kujdesit për të ruajtur Stabilimentet në kontrollin e tij të sigurt nga rreziqet e ndërhyrjeve të paligjshme në operacione, apo të dëmtimit të tyre, nga palët e treta.

#### 4.8 Respektimi i ligjeve

Investitorët në lidhje me sjelljen e Blerësit në përvetësim dhe pronësi të KEDS-it dhe/ose Blerësit në lidhje me interesat e tij në KEDS, si dhe KEDS-i, në çdo kohë do të respektojnë ligjet e Republikës së Kosovës dhe do të mbahen përgjegjës për respektimin e këtyre ligjeve nga zyrtarët, punëtorët, drejtorët, agjentët, kontraktorët dhe Degët e tyre.

#### 4.9 Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve

4.9.1 Pa paragjykuar të drejtën e KEDS-it për të importuar pa kufizim gjitha mallrat dhe shërbimet e nevojshme për ndërmarrjen e Aktivitetit të KEDS-it, si dhe gjithmonë duke iu nënshkruar kërkesave ligjore për prokurimin, KEDS-i do të prokurojë mallra dhe shërbime nga furnizuesit brenda Kosovës deri në masën që është e praktikueshme si dhe në masën që ato janë në dispozicion me cilësinë, standardin, afatin dhe çmimin e kërkuar.

4.9.2 KEDS-i do të prokurojë mallra dhe shërbime në kushte komerciale, si dhe në baza të «gjatësisë së dorës» apo afërsisë me to.

#### 4.10 Të drejtat e punëtorëve të transferuar

KEDS-i merr përsipër të mos bëjë ndryshime materiale të kushteve dhe afateve të punësimit të asnjërit prej punëtorëve që ekzistojnë në datën e Marrëveshjes për Shitblerjen e Aksioneve, përveç nëse bëhet me pëlqimin paraprak të punëtorëve përkatës, përveç nëse përndryshe lejohet sipas kushteve të emërimit të tyre dhe/ose siç kërkohet me ligj. Në pajtim me (i) Kapitullin VIII (Ndërprerja e Marrëdhënies së Punësimit), por duke përjashtuar Nenin 76 (Shkarkimet Kolektive) të atij Kapitulli, në Ligjin nr. 03/L – 212 e Punës në Republikën e Kosovës, bashkë me ndryshimet apo shfuqizimet e tij kohë pas kohe; si dhe (ii) politikat dhe dispozitat e KEK-ut në lidhje me punësimin sipas transferimit dhe/ose miratimit nga KEDS-i:

4.10.1 KEDS-i do të vazhdojë të ruajë punësimin për gjithë punëtorët e tij në datën e Përfundimit (ashtu siç përkufizohet ky term në Marrëveshjen për Shitblerjen e Aksioneve), për një periudhë minimale prej tri vitesh që prej asaj date; si dhe

- 4.10.2 Duke mos anashkaluar asgjë në të kundërtën e përmbytjes së atij Ligji nr. 03/L – 212 për Punën, secili punëtor me kontratë punësimi me periudhë të caktuar që do të skadonte brenda tri viteve prej datës së Përfundimit, do të ketë të drejtë të fitojë vazhdim të asaj kontrate deri në përvjetorin e tretë të asaj date nga data e Përfundimit.
- 4.11 Respektimi i procedurave të specifikuar dhe standardeve të performancës
- 4.11.1 KEDS-i gjatë gjithë kohës do të respektojë **aktet juridike të Kosovës dhe gjitha standardet e vlefshme mjedisore dhe sociale e udhëzimeve të cilat i referohen Parimeve të Ekuatorit.**
- 4.11.2 KEDS-i do të ndërmarrë çdo VNMS sipas dhe kurdo që është nevoja në përputhje me ligjet e Kosovës dhe **standardet e vlefshme mjedisore dhe sociale si dhe udhëzimeve të cilat i referohen Parimet e Ekuatorit** (bashkë me ndryshimet dhe/ose afirmimet e tyre kohë pas kohe). Në pajtim me secilin VNMS, nëse KEDS-i identifikon çështje të caktuara që kërkojnë zbutje apo përmirësim, ai do të përgatisë një plan veprimi si dhe t'ia dorëzojë këtë QeK-së për shqyrtim. Më tutje nga ai dorëzim, KEDS-i do të ndërmarrë gjitha masat e arsyeshme e të domosdoshme të përmirësimit siç theksohet në Planin e Veprimit si dhe për të siguruar që KEDS-i dhe Aktiviteti i KEDS-it të operojnë në respektim të vazhdueshëm të ligjeve të Kosovës, si dhe parimeve të Ekuatorit.
- 4.11.3 KEDS-i do të operojë me Aktivitetin e KEDS-it me sisteme formale e të dokumentuara mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë e menaxhimit social, sipas kërkesave të parimeve të Ekuatorit, si dhe do të sigurojë dhe mirëmbajë Certifikatat e Sistemit Menaxhues ISO14001 dhe OHSAS 18001.
- 4.12 Sjellja
- 4.12.1 Investitorët dhe/ose Blerësi dhe KEDS-i marrin përsipër që ata dhe Degët e tyre të mos bëjnë, ofrojnë, apo autorizojnë, e as që kanë bërë ndonjëherë, ofruar apo autorizuar, në lidhje me çështjet që janë subjekt i kësaj Marrëveshjeje, ndonjë pagesë, dhuratë, premtim apo ndonjë përfitim tjetër, pa marrë parasysh nëse bëhet drejtpërdrejt apo përmes ndonjë personi apo subjekti tjetër, për apo në dobi apo përfitim të ndonjë zyrtari publik (si ndonjë person që mban pozitë legjislative, administrative apo gjyqësore, duke përfshirë personat që janë punësuar apo veprojnë në emër të një agjencie publike, ndërmarrjeje publike apo ndonjë organizate ndërkombëtare publike) apo të ndonjë partie politike apo ndonjë zyrtari apo kandidati partie politike, në të cilin rast ato pagesa, dhurata, premtime apo përfitime do të shkelnin:
- (a) Ligjet e vlefshme të Kosovës;
- (b) Ligjet e vendit të themelimit të Investitorëve apo të kompanive amë të atyre Investitorëve, si dhe të vendit kryesor të biznesit të atyre kompanive përfundimtare amë;
- (c) Parimet e përshkruara me Konventën për Luftimin e Mitozjes së Zyrtarëve të Huaj Publikë në Transaksione Ndërkombëtare Pune, nënshkruar në Paris më 17 dhjetor 1997, që ka hyrë në fuqi më 15 shkurt 1999, si dhe Komentaret e Konventës; apo

- (d) Dispozitat e FCPA-së (sipas përkufizimit si më poshtë). Për qëllimet e këtij neni 4.10.1 “FCPA” do të thotë Akti Amerikan për Praktikën e Korrupsionit të Huaja, përgjithësisht kodifikuar me aktin 15 U.S.C. 78, bashkë me ndryshimet e tij kohë pas kohe; si dhe

Në lidhje me pikat paraprake, KEDS-i do të jetë përgjegjëse për respektimin e këtyre kërkesave nga zyrtarët, punëtorët, drejtorët, agjentët, kontraktorët dhe Degët, si dhe zyrtarët, punëtorët, drejtorët, agjentët dhe kontraktorët.

- 4.12.2 KEDS-i do të mbrojë, zhvendosë dhe ruajë Palët tjera nga dëmet apo ndaj pretendimeve, dëmeve, humbjeve, dënimeve, shpenzimeve dhe kostove që dalin apo ndërlidhen me, secilën shkelje të këtyre garancive nga KEDS-i. Një obligim i tillë për zhvendosje do të tejkalojë edhe ndërprerjen apo skadimin e kësaj Marrëveshjeje.
- 4.12.3 KEDS-i pajtohet të (i) ruajë kontrollet adekuate të brendshme; (ii) regjistrojë dhe raportojë në mënyrën e duhur gjitha transaksionet; si dhe (iii) respektojë gjitha ligjet që vlejné për të. KEDS-i duhet të mbështetet tek sistemet e Palëve të tjera për kontroll të brendshëm, si dhe tek përshtatshmëria e zbulimit të plotë të fakteve, si dhe të të dhënave financiare dhe të dhënave tjera në lidhje me Aktivitetin e KEDS-it.

#### 4.13 Të drejtat e QeK-së për ndërhyrje

Investitorët dhe/ose Blerësi dhe KEDS-i në çdo kohë do të sigurojnë, për dobinë e QeK-së, që të drejtat e Qeverisë për ndërhyrje të mund të ushtrohen nga QeK-ja në lidhje me KEDS-në në mënyrë të shpejtë dhe pa pengesa, si dhe që të gjitha që bëhen dhe janë të domosdoshme në dokumentacionin juridik dhe të regjistruar që përbën KEDS-në, që të drejtat e QeK-së për ndërhyrje të sigurohen dhe të mbrohen.

- 4.14 KEDS-i, Blerësi dhe Investitori kolektivisht pajtohen të investojnë 300 milionë euro (treqind milionë) gjatë një periudhe 15-vjeçare që fillon të rrjedh nga Data e Përmbjlljes, me kusht gjithnjë që ZRRE të japë miratimin dhe të miratojë përfshirjen e ndikimit të këtyre investimeve në tarifatat relevante të Afarizmit të KEDS-it.

## 5. Forca madhore

### *Rastet e Forcës Madhore*

- 5.1 Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, një «Rast Force Madhore» do të nënkuptojë rastet apo rrethanat, apo kombinimin e rasteve e rrethanave (përfshirë edhe efektet e tyre) të cilat janë jashtë kontrollit të arsyeshëm të një Pale, si dhe materialisht e negativisht ndikojnë përmbushjen nga ajo Palë e prekur sipas apo në bazë të kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë aftësinë e Palës që të furnizojë apo pranojë energji elektrike); me kusht, megjithatë, që efektet e tilla materiale e negative të mos kenë qenë të mundshme të parandalohen, anashkalohen apo sanohen plotësisht apo pjesërisht nga Pala e prekur përmes ushtrimit të kujdesit dhe analizës së arsyeshme (si dhe në pajtim me Praktikën e Shfrytëzimit të Matur në rastin e KEDS-it), duke u nënkuptuar dhe pajtuar që kujdesi i arsyeshëm përfshin veprat dhe aktivitetet që janë të arsyeshme në kuptimin e probabilitetit të ngjarjes së atij rasti, efektit të mundshëm të atij rasti nëse ndodh, si dhe efikasitetit të mundshëm të masave mbrojtëse. Me kusht që gjatë gjithë kohës kërkesat e

mësipërme për definimin e një Rasti të Forcës Madhore plotësohen, në vijim janë dhënë rastet e tilla që përfshihen, por që nuk kufizohet tek ato:

- 5.1.1 Zjarri, vërshimi, vetëtima, stuhia, tornadoja, tërmeti, rrëshqitja e tokës;
  - 5.1.2 Sëmundjet epidemike;
  - 5.1.3 Lufta, lufta civile, veprat e armiqve publikë; si dhe/ose
  - 5.1.4 Greva, mbyllja përbrenda apo trazirat tjera industriale.
- 5.2 Rastet e Forcës madhore shprehimisht nuk do të përfshijnë kushtet në vijim, përveç nëse dhe deri në masën që ato raste apo rrethana ngjajnë drejtpërdrejt si pasojë e një Rasti të Forcës Madhore:
- 5.2.1 Dështimi i QeK-së në ushtrimin e autorizimeve të veta të ligjshme; apo
  - 5.2.2 Mungesa e fondeve, si dhe në rastin e KEDS-it, mungesa e fondeve të KEDS-it për shkak të arsyeve komerciale, ekonomike apo financiare, duke përfshirë paaftësinë e cilësdo palë për të krijuar profitin apo për arritjen e një shkalle të arsyeshme të kthimit.
- 5.3 Duke iu nënshtruar respektimit të nenit 5.5, secila Palë do të lirohet nga përmbushja dhe nuk do të jetë në shkelje të obligimeve të kësaj Marrëveshjeje deri në masën që dështimi në përmbushje të atij obligimi është për shkak të një rasti të Forcës Madhore.
- 5.4 Nëse për shkak të një Rasti të Forcës Madhore, Pala është plotësisht apo pjesërisht e paaftë të përmbushë obligimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje, Pala e prekur do:
- 5.4.1 T'i japë Palës tjetër njoftimin për rastin(et) e Forcës Madhore sa më herët që është e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se dyzetetë (48) orë pasi që Pala e prekur është vënë në dijeni të ngjarjes së rastit(eve) të Forcës Madhore;
  - 5.4.2 T'i japë Palës tjetër një njoftim të dytë, ku përshkruhet(n) rasti(et) e Forcës Madhore në hollësi të arsyeshme, si dhe deri në masën që mund të përcaktohet arsyeshmërisht në kohën e atij njoftimi, t'i japë një vlerësim paraprak të obligimeve të prekura, një vlerësim paraprak të periudhës kohore brenda të cilës Pala e prekur do të jetë e paaftë të përmbushë obligimet e tilla, si dhe çështjet tjera përkatëse sa më herët që është e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se shtatë (7) ditë pas njoftimit të parë të ngjarjes së rastit(eve) të Forcës Madhore që jepet nga Pala e prekur. Kurdo që është e mundur, apo arsyeshmërisht kërkohet të bëhet nga Pala tjetër, Pala e prekur do t'i ofrojë Palës tjetër njoftime tjera që përshkruajnë më mirë rastin(et) e Forcës Madhore dhe shkakun(qet) e tij, si dhe duke ofruar apo freskuar informatat në lidhje me përpjekjet e Palës së prekur për të shmangur dhe/ose zbutur efektin(et) e tyre, si dhe vlerësimet, deri në masën e mundshme, të kohës brenda të cilës Pala e prekur me arsye pret që të mos jetë në gjendje të përmbushë obligimet e veta të prekura nga rasti(et) e Forcës Madhore;
  - 5.4.3 Pala e prekur pastaj njofton Palën tjetër:
    - (a) Në lidhje me rastet e vazhdueshme të Forcës Madhore, për pushimin e ekzistencës së Rastit të Forcës Madhore, si dhe

- (b) Për aftësinë e saj për të rifilluar përmbushjen e obligimeve të veta sipas kësaj Marrëveshjeje

Sa më herët që është e mundur, si dhe në çdo rast jo më vonë se shtatë (7) ditë pas ngjarjes së rasteve sipas pikës (a) dhe (b) si më lart; si dhe

5.4.4 Dështimi i Palës së prekur që të bëjë njoftimin me shkrim për një Rast të Forcës Madhore tek Pala tjetër brenda periudhës dyzetetëtorëshe (48) nuk e kufizon Palën tjetër që të japë një njoftim të tillë në një periudhë të mëvonshme; me kusht, megjithatë, që në një rast të tillë, Pala e prekur të mos justifikohet për dështime apo vonesa në përmbushje të obligimeve sipas apo në bazë të kësaj Marrëveshjeje deri në kohën që bëhet ai njoftim. Nëse njoftimi në fjalë jepet brenda periudhës prej dyzetetë (48) orësh sipas kërkesave të nenit 5.8, Pala e prekur do të falet për dështimet apo vonesat e tilla sipas Nenit, nga koha e fillimit të Rastit të Forcës Madhore.

5.5 Pala e prekur do të bëjë gjitha përpjekjet e arsyeshme për zbutjen e efekteve të rastit të Forcës Madhore, duke përfshirë, por pa u kufizuar, edhe pagesën e shumave të arsyeshme të parave nga ose në emër të Palës së prekur, shuma këto që janë të arsyeshme në kuptimin e efikasitetit të mundshëm të masave zbutëse.

5.6 Nëse Rasti i Forcës madhore që rrjedh nga lufta, lufta civile dhe/ose aktet e armiqve publikë ndodh duke shkaktuar dëme që bën një pjesë të Stabilimenteve të humbë plotësisht, në atë mënyrë që pas rivendosjes pasuese, të ardhurat e KEDS-it nuk do të ishin të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e veta të rivendosjes dhe operimit të pjesës së prekur të Stabilimenteve, duke marrë parasysh të ardhurat e sigurimeve në dispozicion, atëherë KEDS-i nuk do të obligohet të rindërtojë apo rivendosë atë pjesë të Stabilimenteve, përveç nëse dhe deri në masën që Palët mund të pajtohen mbi kushtet e një rivendosjeje të tillë.

## 6. Zhdëmtimet

### 6.1 Zhdëmtimi i QeK-së

QeK do të kompensojë, zhdëmtojë dhe lirojë plotësisht KEDS-në nga humbjet, kostot, dëmet dhe shpenzimet që i barten KEDS-it, duke përfshirë pretendimet e palëve të treta për humbjet, dëmet dhe shpenzimet (pa marrë parasysh nëse është pasojë e neglizhencës apo shkelje të obligimit ligjor nga QeK-ja, si dhe nëse ka qenë e parashikueshme në datën e kësaj Marrëveshjeje), që rrjedh nga apo është në lidhje me:

6.1.1 ndonjë mospërmbushje nga QeK-ja apo/dhe KEK-u të standardeve mjedisore që prekin ndonjë pjesë të Aktivitetit të KEDS-it para datës së Datës së Përfundimit, apo kushteve mjedisore që prekin ndonjë pjesë të Aktivitetit në datën e Përfundimit, të cilat më vonë shihen të mos jenë në përputhje me Standardet Mjedisore përkatëse, ose

6.1.2 Zbatimin nga KEK-u të MFSH-së dhe MFI-së, që rrjedh nga ndonjë vepër apo mosveprim apo shkelje të detyrës ligjore të QeK-së në lidhje me të; ose

E drejta për mbrojtjen e veprimit

6.2 QeK do të ketë të drejtë, por jo detyrë, të dalë në mbrojtje të pretendimeve të palëve të treta që referohen në nenin 6.1. Secila Palë, sa më herët që është e mundur pas marrjes së njoftimit të ndonjë pretendime që bëhet ndaj saj, do t'i ofrojë Palës tjetër zhdëmtuese gjitha detajet për të, si dhe do t'i sigurojë gjithë ndihmën e arsyeshme që kërkohet nga ajo Palë në mbrojtjen e atij pretendimi nga ajo palë e tretë. Obligimet, zhdëmtimet dhe detyrimet e sipërme që merren

përsipër nga Palët e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikohet nga kufizimet e sigurimeve që mbahen nga Palët.

Pala e zhdëmtuar të mos bëjë kompromis

### 6.3

6.3.1 Aty ku QeK ka obligim sipas nenit 6.1 të zhdëmtojë KEDS-në, KEDS-i nuk do të bëjë kompromis e as të rregullojë në asnjë mënyrë asnjë pretendim, padi, veprim apo shkak veprimi pa pëlqimin me shkrim të dhënë shprehimisht nga QeK-ja. Në rastet kur pëlqimi i tillë nuk sigurohet para kompromisit apo rregullimit të tillë, QeK-ja lirohet dhe shkarkohet nga gjitha obligimet sipas nenit 6.1.1 apo 6.1.2, sipas rastit.

6.3.2 Secila pagesë që duhet bërë nga QeK-ja për Palën e zhdëmtuar sipas këtij neni 6 duhet paguar brenda dyzetepesë (45) ditësh nga data në të cilën Pala e zhdëmtuar bën pagesën në lidhje me pretendimin e palës së tretë, e cila fillimisht është pëlqyer me shkrim nga QeK-ja.

## 7. Nuk përdoret

## 8. Shkëputja

### *Rastet e mospërbushjes nga KEDS*

8.1 Secili prej rasteve të përshkruara më poshtë përbën Rast të Mospërbushjes nga KEDS-i:

- (a) Shkelja nga KEDS-i e cilitdo obligim material sipas kësaj Marrëveshjeje, e cila (kudo që është e mundur të sanohet) nuk sanohet brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga njoftimi i QeK-së që thekson që shkelja e tillë është bërë, duke identifikuar shkeljen në fjalë në hollësi të arsyeshme dhe duke kërkuar sanimin e saj, me kusht që, nëse KEDS-i ka filluar me kujdes dhe sa më shpejt që është e mundur veprimet e domosdoshme të sanimit, por nuk është në gjendje t'i përfundojë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas datës së atij njoftimi, do të lejohet për një periudhë të caktuar të arsyeshme për përfundimin e veprimeve sanuese, por e cila nuk kalon gjashtëdhjetë (60) ditë të tjera;
- (b) Shkelja nga Investitorët, Blerësi dhe/ose KEDS-i të ndonjërës prej dispozitave të nenit 4.1;
- (c) Shpërbërja, përbashkimi, konsolidimi, bashkëngjitja, riorganizimi apo rindërtimi i KEDS-it, përveç deri në masën që nuk ndikon në aftësinë e subjektit pasues në përmbushje të obligimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (d) Përveç qëllimeve të lejuara sipas paragrafit (b), ngjarja e cilitdo prej rasteve në vijim (përveç nëse janë rezultat i drejtpërdrejtë i Rasteve të Mospërbushjes nga QeK-ja):
  - (i) Miratimi i një rezolute apo inicimi i një procedure për bankrotim, insolvencë, mbyllje, likuidim apo procedura të ngjashme që kanë të bëjnë me KEDS-në;

- (ii) Emërimi i një institucioni mirëbesimi, likuiduesi, kujdestari apo personi të ngjashëm në procedurë të referuar në paragrafin (c)(i), emërimi i të cilit nuk është anashkaluar apo suspenduar brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga emërimi i tillë; ose
- (iii) Lëshimi i një urdhri nga një gjykatë me juridiksion që përmbyll apo përndryshe konfirmon bankrotimin apo insolvencën e KEDS-it, urdhër i cili nuk është anashkaluar apo suspenduar brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh;

## 8.2 Pasojat e rasteve të Mospërbushjes nga KEDS-i

Nëse KEDS-i kryen një Rast të Mospërbushjes nga KEDS-i, QeK mundet, me njoftim, të ndërpresë këtë Marrëveshje me efekt nga data e specifikuar në atë njoftim, por jo më herët sesa njëzetën (21) ditë nga data e atij njoftimi. Në rastin e ndonjë riorganaizimi të KEDS-it sipas nenit 4.2 dhe kur një Degë e ndërlidhur ka shkaktuar një Rast të Mospërbushjes nga KEDS-i, atëherë QeK-ja mund të shkëpusë vetëm ato të drejta dhe obligime që rrjedhin sipas apo në ndërlidhje me këtë Marrëveshje, që kanë të bëjnë me atë Degë, me atë njoftim ndërprerjeje.

## 8.3 Shkëputja

8.3.1 Kjo Marrëveshje do të ndërpritet automatikisht, pa pasur nevojë që Palët të ndërmarrin asnjë veprim të mëtutjeshëm:

- (a) Nëse Përfundimi (ashtu siç është definuar) me Marrëveshjen për Shitblerjen e Aksioneve nuk arrihet deri në Datën e Ndalimit të Largët, ashtu siç definohet ky term në MSHA; ose
- (b) Cilado që ngjan më vonë, për ndërprerjen e licencës së furnizimit publik të energjisë elektrike ose për licencën e operimit të sistemit të distribuimit të energjisë elektrike, dhënë apo bartur në kohën e Përfundimit (siç është definuar ai) sipas Marrëveshjes për Shitblerjen e Aksioneve; ose
- (c) Në datën e ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje të specifikuar në njoftimin për ndërprerje sipas nenit 8.2 (por jo në rastin kur QeK-ja ndërpre vetëm ato të drejta dhe obligime që rrjedhin sipas apo në lidhje me këtë Marrëveshje, që kanë të bëjnë me një Degë),

Përveç nëse njoftimi i tillë i ndërprerjes tërhiqet.

8.3.2 Pa anashkaluar asgjë në përmbajtje të kësaj Marrëveshjeje, QeK-ja nuk do të iniciojë asnjë veprim kundër KEDS-it në lidhje me rastet e Mospërbushjes nga KEDS-i apo ndonjë shkelje tjetër nga KEDS-i të obligimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse KEK-u ka iniciuar një veprim sipas MFSH-së dhe/ose MFI-së kundër KEDS-it në lidhje me atë që në thelb është e njëjta gjë.

8.3.3 Sipas nenit 8.4, në ndërprerje të kësaj Marrëveshjeje, asnjëra Palë nuk do të mbajë përgjegjësi para tjetrës për dëmet apo humbjet, qoftë sipas kësaj Marrëveshjeje, sipas ligjit apo ndryshe, përveç në lidhje me të drejtat e fituara nga ajo Palë sipas kësaj Marrëveshjeje para ndërprerjes së saj.

8.3.4 Rastet e specifikuara në këtë nen do të jenë bazat e vetme mbi të cilat kjo Marrëveshje mund të ndërpritet.



#### 8.4 Pasojat e ndërprerjes.

Në rast të ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje për cilëndo arsye (përveç atyre në nenet 8.3.1 (a) dhe 8.3.1(b)), atëherë:

- 8.4.1 QeK do të ketë të drejtë të ushtrojë të Drejtat e QeK-së për Hyrje në lidhje me KEDS-në; si dhe
- 8.4.2 QeK-ja do të ketë të drejtë t'i kërkojë Blerësit, ndërsa Blerësi jep pëlqimin sipas kësaj Marrëveshjeje, të bartë aksionet në KEDS që në atë kohë mbahen nga Blerësi menjëherë dhe pa kurrfarë pagese nga ana e QeK-së dhe Investitorët dhe/ose Blerësi do të kenë përgjegjësi para QeK-së për çdo dhe gjitha kostot, humbjet dhe shpenzimet (duke përfshirë shpenzimet për këshilltarë ligjorë e profesionalë), të shkaktuara nga QeK-ja në lidhje me vonesat apo dështimet e Blerësit në finalizim të asaj bartjeje; si dhe

Për qëllimet e këtij neni 8.4, të «Drejtat e QeK-së për Hyrje» do të thonë të drejtat e QeK-së që të emërojë anëtarë të Bordeve të KEDS-it dhe Degëve të tij dhe që të marrë kontrollin mbi menaxhimin e KEDS-it dhe Degëve të tij, si dhe gjitha aktivitetet që ndërmerren nga KEDS-i. Të drejtat e QeK-së dhe obligimet e Investitorëve dhe/ose Blerësit sipas këtij neni 8.4 do të vlejnjë edhe përtej ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje.

### 9. Zgjidhja e kontesteve

9.1 Secila mosmarrëveshje, dallim, kundërthënie apo pretendim që rrjedh nga apo ka të bëjë me këtë Marrëveshje, ose shkelje, ndërprerje apo pavlefshmëri e saj, që nuk zgjidhet fillimisht në mënyrë miqësore ("Mosmarrëveshja"), do të zgjidhet ekskluzivisht dhe përfundimisht me arbitrazh në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Tregtare Ndërkombëtare ("UNCITRAL") ashtu siç janë aktualisht në fuqi, ose, në mungesë të rregullave, ose deri në masën që disa rregulla të caktuara nga Rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL janë përjashtuar në mënyrë specifike sipas Marrëveshjes, në pajtim me ligjet procedurale të Zvicrës, me kusht që:

- 9.1.1 Deklarimi i pretendimit dhe njoftimi i emërimit të një arbitri duhet përfshirë në njoftimin e arbitrazhit;
- 9.1.2 Autoriteti emëruar do të jetë Kryetari i Odës Ekonomike të Gjenevës; numri i arbitërve do të jetë tre (3);
- 9.1.3 Vendi i arbitrazhit do të jetë Gjeneva, Zvicër;
- 9.1.4 Gjuha që përdoret në procedurat e arbitrazhit do të jetë anglishtja;
- 9.1.5 Neni 22 i Rregullave të UNCITRAL-it nuk vlen, derisa Palët nuk lejohen të ndryshojnë apo plotësojnë deklarinin e vet të pretendimit, apo deklaratën e mbrojtjes, përveç nëse Pala tjetër pajtohet me shkrim, ose nëse tribunali i arbitrazhit e konsideron të nevojshme të lejojë një ndryshim apo plotësim të tillë, duke marrë parasysh vonesën në hartimin e tyre, si dhe paragjykimet e mundshme që i shkaktohen Palës tjetër, apo edhe rrethanat tjera përkatëse;
- 9.1.6 Secila Palë mund të kërkojë dëgjim verbal, por tribunali i arbitrazhit i themeluar në bazë të këtij neni 9.10 ("Tribunali i Arbitrazhit") do të gëzojë lirinë e plotë të veprimit për të vendosur mbajtjen e një dëgjimi të tillë, përveç nëse kërkesa mbështetet edhe nga Pala tjetër;

- 9.1.7 Tribunali i Arbitrazhit nuk do të autorizohet të vendosë si "*amiables compositeurs*" ose "*ex aequo et bono*" ose të aplikojë nenin 27, paragrafi 3, e as nenin 29, paragrafi 3 të Rregullave të Arbitrazhit të UNCITRAL-it, deri në atë masë që dispozitat e tilla kanë të bëjnë me inspektimin apo dorëzimin e dokumenteve. Tribunali i Arbitrazhit mund t'i kërkojë Palëve të dorëzojnë dokumente, prova apo dëshmi të tjera që Tribunali i Arbitrazhit i konsideron të jenë relevante brenda asaj periudhe kohore që ai përcakton. Nëse Pala që ka barrën e dëshmisë së fakteve në të cilat bazohet për të mbështetur pretendimin apo mbrojtjen e saj nuk ka vullnetin të zbulojë dokumente, prova e dëshmi të tilla, atëherë Tribunali i Arbitrazhit do të jetë i lirë të shqyrtojë nëse në gjitha rrethanat, ato fakte janë vërtetuar apo jo;
- 9.1.8 Neni 37 dhe neni 39 i Rregullave të Arbitrazhit të UNCITRAL-it nuk do të vlejnjë;
- 9.1.9 Tribunali i Arbitrazhit nuk do të ketë të drejtë t'i japë vendimin pjesërisht në favor, apo një vendim kalimtar që përmban masat e përshkruara në nenin 26 të Rregullave të UNCITRAL-it; si dhe
- 9.1.10 Vendimi i Tribunalit të Arbitrazhit do të jetë përfundimtar dhe obligativ për Palët, duke pasur parasysh që:
- (a) Paragrafët (a), (b) dhe (d) të nenit 190(2) të Aktit Federal Zviceran për të Drejtën Private Ndërkombëtare do të vlejnjë; si dhe
  - (b) Paragrafi (c) i nenit 190 (2) të përmendur do të vlejë vetëm për një veprim për ndarjen anash të pjesës së vendimit që pohohet të ketë qenë përtej pretendimeve të dorëzuara tek Tribunali i Arbitrazhit; në asnjë kuptim tjetër nuk mund të ndërmerret një veprim për ndarjen anash të një vendimi sipas paragrafit (c) të përmendur.
- 9.2 Vendimi i tillë mundet, sipas nevojës, të ekzekutohet nga ndonjë gjykatë apo autoritet tjetër kompetent. Përveç rasteve si më sipër, gjitha të drejtat e ankesës, anulimit, si dhe të parashtrimit në një gjykatë drejtësie përjashtohen me këtë marrëveshje në lidhje me arbitrazhin sipas Marrëveshjes, si dhe vendimeve që prodhohen nga ai.
- 9.3 Palët pranojnë dhe njohin që kjo Marrëveshje përbën një transaksion komercial, në kuptimin e të cilit asnjëra Palë nuk ka të drejtë të kërkojë imunitet sovran. Shitësi dhe Blerësi me këtë marrëveshje mohojnë në mënyrë të pakushtëzuar dhe të parevokueshme imunitetin sovran në çfarëdo veprimi për të kushtëzuar arbitrazhin sipas kësaj Marrëveshjeje, apo për të ekzekutuar apo zbatuar ndonjë vendim të nxjerrë në procedura arbitrazhi, sipas kësaj Marrëveshjeje.
- 9.4 Vendimi i dhënë në arbitrazh që është iniciuar sipas këtij dokumenti, apo urdhri që jepet nga një gjykatë kompetente në bazë të ligjit në fuqi në lidhje me çështjet e ndërlidhura me Mosmarrëveshjen në pritje të përfundimit të procedurës së arbitrazhit mund të trajtohet në gjykatat që kanë juridiksion për ekzekutimin e tij.
- 9.5 Asnjë palë në Mosmarrëveshje nuk do të ketë të drejtë të iniciojë apo vazhdojë padinë apo procedurën juridike në lidhje me Mosmarrëveshjen sipas kësaj Marrëveshjeje në asnjë gjykatë, as në Kosovë apo jashtë saj, derisa Mosmarrëveshja të jetë përcaktuar në pajtim me procedurën e arbitrazhit të përcaktuar këtu, si dhe vetëm pastaj të ekzekutohet apo të mundësohet ekzekutimi i vendimit që merret në atë arbitrazh.
- 9.6 Gjatë procesit të arbitrazhit sipas kësaj Marrëveshjeje:

- 9.6.1 QeK-ja, KEK-u, Investitorët, Blerësi dhe KEDS-i do të vazhdojnë të përmbushin obligimet e tyre përkatëse sipas kësaj Marrëveshjeje; si dhe
- 9.6.2 As QeK-ja, KEK-u, Investitorët, Blerësi e as KEDS-i nuk do të ushtrojnë asnjë mjet tjetër juridik që rrjedh për shkak të çështjeve në Mosmarrëveshje.
- 9.7 Secili vendim që merret si pasojë e arbitrazhit sipas kësaj Marrëveshjeje do të përbëjë “vendim të huaj” brenda kuptimit në Konventën e Nju-Jorkut për njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit dhe Zbatimit të Aktgjykimeve të Huaja, Ligji nr. 8, i vitit 1952.

## **10. Ligji i zbatueshëm**

Kjo Marrëveshje do të qeveriset dhe interpretohet në gjitha kuptimet në pajtim me ligjet e Kosovës.

## **11. Valuta, data e pagesës dhe vonesa e pagesave**

- 11.1 Gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen në Euro/Dollarë Amerikanë, si dhe mund të bëhen në Euro/Dollarë amerikanë në shumën ekuivalente të pagesës në Euro/Dollarë në shkallën e këmbimit që regjistrohet në datën e pagesës, të certifikuar nga Banka Qendrore e Kosovës.
- 11.2 Pala pranuese e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje do t’ia faturojë Palës tjetër shumën, bashkë me kalkulimet mbështetëse të shumave të kërkuara, si dhe në rastet kur Pala mbështetet tek të dhënat dhe dokumentet që i mirëmban, të dhënat dhe dokumentet e tilla do të vihen në dispozicion për inspektim nga Pala tjetër, me njoftim të arsyeshëm paraprak.
- 11.3 Përveç nëse nuk parashihet ndryshe me këtë Marrëveshje, çdo shumë që duhet paguar nga njëra Palë për Palën tjetër në bazë të kësaj Marrëveshjeje duhet paguar brenda dyzetepesë (45) ditësh nga data e dorëzimit të faturës nga Pala, si dhe kurdo që kontestohet, pranohet apo përcaktohet.
- 11.4 Kur bën pagesën e një shume të kontestuar, Pala paguese do të paguajë kamatë:
- 11.4.1 Në shkallën referente të interesit, nëse shuma e paguar është më e vogël sesa shuma e kontestuar; ose
- 11.4.2 Në Shkallën e Pasafatshme, nëse e gjithë shuma e kontestuar duhet paguar,

Nga data e duhur për pagesë të Faturës e deri në datën e pagesës, duke përjashtuar këtë të fundit.

## **12. Ekzekutimi**

- 12.1 Duke iu nënshtruar të drejtës së apelit, apelit të dytë, revizionit apo procedurave apo mjeteve tjera juridike në dispozicion të KEK-ut dhe KEDS-it sipas ligjit, edhe KEDS-i edhe KEK-u japin pëlqimin në lidhje me ekzekutimin e aktgjykimeve të plotfuqishme ndaj tyre në çdo procedurë, pa marrë parasysh a është në Kosovë apo jashtë saj, si dhe për kompensim apo çështje tjera të çdo procesi në lidhje me ato procedura (duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, zbatimin apo ekzekutimin ndaj tyre apo në lidhje me cilëndo pronë, pa marrë parasysh destinimin e saj aktual apo të synuar, duke përfshirë pronat që gjenden jashtë Kosovës).

## **13. Imuniteti sovran**

Nëse QeK-ja dhe/ose KEK-u mund të pretendojnë në cilindo juridiksion për veten apo pasuritë apo të ardhurat e tyre imunitet nga paditë, ekzekutimi, bashkimi në procedurë (si në ekzekutim,

para aktgjykimit apo ndryshe) apo ndonjë procesi tjetër ligjor në cilindo juridiksion, si dhe nëse në atë juridiksion ai imunitet mund t'i atribuohet atyre apo pasurive e të ardhurave të tyre (pa marrë parasysh a pretendohet apo jo), atëherë QeK-ja dhe/ose KEK-u pajtohen të mos pretendojnë imunitetin, si dhe në mënyrë të përvokueshme tërhiqen nga imuniteti i tillë deri në masën e plotë që lejohet nga ligjet e atij juridiksioni. Për më shumë, QeK-ja, në mënyrë të pakushtëzuar dhe të përvokueshme, si dhe deri në masën maksimale që lejohet me ligj:

- 13.1.1 Pajtohet që ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje nga ajo nuk përbën akt sovran;
- 13.1.2 Pajtohet që, nëse procedurat iniciohen kundër saj në lidhje me këtë Marrëveshje apo ndonjë transaksion që paraprihet me këtë Marrëveshje, nuk do të kërkojë imunitet sovran, për vete apo në emër të vetes, nga ato procedura, deri në masën që përndryshe do të kishte të drejtë ta bënte këtë brenda ligjit; si dhe
- 13.1.3 Deri në masën maksimale të lejuar me ligj, tërhiqet nga gjitha të drejtat për imunitet sovran që vetë apo ndonjë subjekt tjetër ka apo mund të ketë në të ardhmen.

#### **14. Njoftimet**

14.1 Gjitha njoftimet e dhëna sipas kësaj Marrëveshjeje duhen bërë me shkrim në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, si dhe gjitha certifikatat, njoftimet apo udhëzimet e shkruara që duhen dorëzuar sipas kësaj Marrëveshjeje do të dorëzohen duke dërguar të njëjtat me postë, faks, apo duke i lënë të njëjta si më poshtë:

- 14.1.1 Në rastin e QeK-së, Kabineti i Ministrit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Adresa: Ish-Toskana; Rr. Nëna Terezë, për vëmendjen e: Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Fax: + 381 (0) 38 213 955;
- 14.1.2 Në rastin e KEK-ut, TC Kosova B, Obiliq/Kastriot, Republika e Kosovës, për vëmendjen e: Drejtorit Menaxhues, Fax: + 381 (0) 38 527 275;
- 14.1.3 Çalik Enerji Sanayi ve Ticaret A.Ş., Çalik Elektrik Dağıtım A.Ş. dhe Limak Yatırım Enerji Üretim İşletme Hizmetleri ve İnşaat A.Ş - Adresa: Hafta Sokak Nr.9 GOP Ankarë Turqi, Fax: +90 312 437 3846 , për vëmendjen e: Z. Mesut Serhat Dinç, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm, Energy Group;
- 14.1.4 Kosovo Çalik Limak Energy Sh.A., Qyteza Pejton, Mbreti Zog 1. No. 09 Prishtinë 10000, Kosovë, Fax: +381 38 609 258; për vëmendjen e: Z. Mesut Serhat Dinç, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm, Energy Group;
- 14.1.5 Në rastin e KEDS-it: Ndërtesa e Elektrokosovës, Nr.3 Bulevardi Bill Klinton, Prishtinë, Republika e Kosovës, për vëmendjen e: Drejtorit Menaxhues, Fax: + 381 (0) 38 501 701 1153, dhe + 381 (0) 38 501 701 1144.

Apo adresat tjera apo numrat tjerë të faksimilit të njoftuar për qëllimet e këtij Neni; si dhe

14.2 Njoftimet e dhëna me shkrim dhe të dorëzuara personalisht, apo dërguar me postë të parapaguar të klasës së parë (ajrore nëse përtej oqeanit), ose transmetimi me faksimil, konsiderohen të jenë efektive dhe të jenë pranuar:

- (a) në rastin e dorëzimit me dorë kur bëhet dorëzimi personal; ose

(b) në rastin e postës së parapaguar të klasës së parë, në ditën e dytë (2) pas ditës së postimit, ose nëse dërgohet me postë ajrore jashtë Kosovës, në ditën e pestë (5) prej ditës së dërgimit; ose

(c) në rastin e transmetimit me faksimil, në kohën e pranimit të regjistruar.

Secila Palë e Marrëveshjes mund të ndërrojë adresën/adresat e veta të regjistruara, numrat e faksimileve, me njoftim paraprak për Palën tjetër.

14.3 Në rastin e mospërputhjeve mes versioneve në gjuhën angleze dhe atë shqipe, teksti në gjuhën angleze mbizotëron.

14.4 Pala mund të njoftojë Palët tjera për ndërrimin e emrit, të adresuarve, adresës apo numrit të faksimiles, për qëllimet e nenit 14.1, me kusht që ai njoftim të jetë efektiv vetëm në:

14.4.1 Datën e dhënë në njoftim si data kur do të bëhet ai ndërrim; ose

14.4.2 Nëse nuk jepet datë, apo data e dhënë është më pak se pesë (5) ditë pune pas datës në të cilën është dhënë ai njoftim, në datën që bie pas pesë (5) ditësh pune pas dhënies së njoftimit për atë ndërrim.

## **15. Konfidencialiteti dhe publiciteti**

Palët pranojnë që kjo Marrëveshje do të jetë dokument në dispozicion të publikut.

## **16. Ndryshimet**

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet apo ndërrohet vetëm me pajtimin me shkrim mes dy Palëve.

## **17. Mohimet**

17.1 Asnjë mohim apo dështim i një Pale për të insistuar në përmbushje të plotë të kësaj Marrëveshjeje apo për të vepruar në kuptimin e shkeljeve të palës tjetër, si dhe asnjë pranim i pagesës apo përmbushjes gjatë vazhdimit të një shkeljeje të tillë, nuk parandalon të drejtat, kompensimet apo mjetet juridike sipas Marrëveshjes, apo në lidhje me këtë Marrëveshje që janë në dispozicion të Palës që nuk ka bërë shkelje, si dhe nuk mund të interpretohen nga Pala në shkelje si pëlqim për ato shkelje, apo për përsëritjen e asaj apo atyre shkeljeve.

## **18. Pasardhësit**

Kjo Marrëveshje obligon dhe siguron dobinë e Palëve dhe pasardhësve të tyre përkatës dhe të deleguarve të tyre të lejuar.

## **19. Caktimi dhe bartja e interesit**

19.1 Dispozitat në vijim do të vlejnjë për caktimin apo bartjen e kësaj Marrëveshjeje:

19.1.1 QeK-ja nuk do t'i caktojë e as bartë gjitha apo një pjesë të të drejtave, përfitimeve apo obligimeve sipas kësaj Marrëveshjeje askujt përveç KEDS-it (duke përfshirë KEDS-në dhe KEDS-në) si dhe pëlqimi paraprak me shkrim i Investitorëve dhe/ose Blerësit nuk do të pengohet pa arsye;

19.1.2 KEK-u nuk do t'i caktojë e as bartë gjitha apo një pjesë të të drejtave, përfitimeve apo obligimeve sipas kësaj Marrëveshjeje askujt përveç KEDS-it (duke përfshirë KEDS-në dhe KEDS-në) si dhe pëlqimi paraprak me shkrim i Investitorëve dhe/ose Blerësit nuk do të pengohet pa arsye;

19.1.3 Në pajtim gjithmonë me kërkesat ligjore të ZRRE-së, KEDS-i nuk do t'i caktojë e as bartë gjitha apo një pjesë të të drejtave, përfitimeve apo obligimeve sipas kësaj Marrëveshjeje askujt përveç me pëlqimin paraprak me shkrim nga QeK-ja, pëlqim ky që jepet nga QeK-ja në liri të plotë të veprimit.

## **20. Ndashmëria**

20.1 Nëse për çfarëdo arsye, cilado dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është apo bëhet e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme, ose shpallet nga një gjykatë e juridiksionit kompetent, apo nga ndonjë Autoritet tjetër Kompetent si e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme, ose nëse ai Autoritet Kompetent:

20.1.1 Refuzon apo formalisht shfaq qëllimin për të refuzuar autorizimin, apo përjashtimin, e dispozitave apo rregulimeve sipas kësaj Marrëveshjeje (në rastin e refuzimit ose me anë të refuzimit të drejtpërdrejtë, ose në mënyrën e një kërkesë që kjo Marrëveshje të ndryshohet apo që dispozitat e saj të shlyhen, ose që Pala të bëjë ndonjë veprim apo të pranojë një kusht në lidhje me sjelljen në të ardhmen); ose

20.1.2 Formalisht thekson që vazhdimi i operimit të këtyre dispozitave të kësaj Marrëveshjeje mund t'i ekspozojë Palët ndaj sanksioneve sipas ligjeve, urdhrave, vendimeve apo rregulloreve, apo i kërkon ndonjëherë Palë që të bëjë përpjekje apo të pranojë kushte në lidhje me sjelljen në të ardhmen ashtu që ajo Palë të mos i nënshtrohet sanksioneve të tilla; kështu

Në gjitha rastet, pa marrë parasysh nëse është fillimisht apo në përfundim të ndonjë periudhe apo periudhave të hershme të përjashtimit (lirimit), palët do të negociojnë në mirëbesim me qëllim të rënies dakord mbi një apo më shumë dispozita që mund të zëvendësohen për ato dispozita të pavlefshme, të pazbatueshme apo të paligjshme, të cilat dispozita zëvendësuese janë të kënaqshme për gjitha Autoritetet përkatëse Kompetente dhe prodhojnë aq afërsisht që është e mundur në gjitha rrethanat baraspeshën e duhur të interesave komerciale të Palëve.

## **21. Marrëdhënia mes Palëve**

21.1 Kjo Marrëveshje nuk krijon shoqëri, projekt të përbashkët, apo partneritet mes Palëve.

21.2 Asnjëra Palë nuk ka të drejtë, pushtet apo autoritet të nënshkruajë marrëveshje apo sipërmarrje për vete, apo për të vepruar në emër të, apo për të vepruar apo për të qenë agjent apo përfaqësues, apo përndryshe të obligojë, tjerën.

## **22. Mirëbesimi**

Palët marrin përsipër të veprojnë në mirëbesim në kuptimin e përmbushjes dhe implementimit të kësaj Marrëveshjeje, si dhe për të marrë masa të tjera të arsyeshme sipas nevojës për realizimin e synimeve të veta.

**23. Sigurimi i mëtutjeshëm**

Secila Palë pajtohet të ekzekutojë dhe përmbushë gjitha instrumentet tjera dhe të kryejë e të përmbushë gjitha aktet dhe gjërat tjera në masë të arsyeshme dhe të domosdoshme për përmbushjen e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

**24. Tërësia e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje përbën të gjithë pajtimin mes palëve në lidhje me objektin e marrëveshjes, si dhe përjashton gjitha përfaqësimet, negociatat dhe sipërmarrjet tjera paraprake.

Përveç në rast të mashtrimit, gjitha përfaqësimet, negociatat dhe sipërmarrjet tjera paraprake të çfarëdo natyre mes Palëve me çfarëdo ndikimi në lëndën e kësaj Marrëveshjeje shfuqizohen dhe shlyhen, si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga to, pa marrë parasysh nëse akumulohen apo jo në datën e kësaj Marrëveshjeje, anulohen, deri në masën e atij ndikimi që kanë.

**25. Kostot**

Secila Palë do të marrë përsipër gjitha kostot dhe shpenzimet që krijohen nga to në lidhje me hyrjen në këtë Marrëveshje.

**26. Tejkalimi i afatit**

Neni 1, 8.3.3, 8.4, 9, 10, 12, 13, 14 dhe 15 Shtojca 1 do të vazhdojnë vlefshëminë edhe përtej ndërprerjes së Marrëveshjes, pa kufizim në lidhje me kohëzgjatjen e periudhës së vlefshmërisë, përveç nëse përshkruhet ndryshe me këtë Marrëveshje.

**27. Kopjet**

Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet për secilin numër të homologëve, të cilët të marrë së bashku përbëjnë një dhe të vetmin dokument.

**28. Variacionet**

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet apo ndërrohet vetëm me pajtimin me shkrim të të gjitha Palëve.

**NË DËSHMI TË SAJ**, Palët pajtohen të ekzekutojnë këtë Marrëveshje që prej datës së parë të shkruar si më lart.

**Për dhe në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës**

**Nga:** \_\_\_\_\_

Emri: **Z. Besim Beqaj**

Titulli: **Ministër, Ministria e Zhvillimit Ekonomik**

**Për dhe në emër të KEK-ut, në prani të:**

---

Emri: **Z. Arben Gjukaj**  
Titulli: **Drejtor Menaxhues, KEK**

---

Emri: **Z. Fadil Çitaku**  
Titulli: **Kryesues, Bordi i Drejtorëve, KEK**

**Për dhe në emër të Investitorëve, në prani të:**

---

Emri: **Nuretin Türkoğlu**  
Titulli: **Çalık Enerji Sanayi ve Ticaret A.Ş**

---

Emri: **Nuretin Türkoğlu**  
Titulli: **Çalık Elektrik Dağıtım A.Ş**

---

Emri: **Mesut Serhat Dinç**  
Titulli: **Limak Yatırım Enerji Üretim İşletme Hizmetleri ve İnşaat A.Ş**

**Për dhe në emër të Blerësit në prani të:**

---

Emri: **Ismail Ergüneş**  
Titulli: **Anëtar i Bordit Ekzekutiv, Kosovo Çalık Limak Energy Sh.A**

---

Emri: **Nuretin Türkoğlu**



Titulli: **Kryesues i Bordit Ekzekutiv, Kosovo Çalik Limak Energy Sh.A**

---

Emri: **Nihat Özdemir**

Titulli: **Kryesues i Bordit, Kosovo Çalik Limak Energy Sh.A**

**Për dhe në emër të KEDS-it në prani të:**

---

Emri: **Mujë Rugova**

Titulli: **Drejtor i Bordit të Drejtorëve, KEDS**

*Për saktësimin e përkthimit nga gjuha angleze  
në gjuhën shqipe vertetohet:*



*Mujë Rugova*